



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 107, datë 05.07.2019

PËR

CAKTIMIN E LIMITIT TË KARBURANTIT PËR AUTOMJETET NË DISPOZICION TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 96, pika 5 e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe të përgjegjësisive të ngarkuara, për detyrat që ato kryejnë, si dhe për mirëfunksionimin normal të punës, për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Konsumi mujor i karburantit, për automjetin në dispozicion të Kryetares së Këshillit Lartë Gjyqësor, do të jetë pa limit.
2. Limiti mujor i konsumit të karburantit për çdo automjet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të jetë 150 litra, për çdo muaj.
3. Për automjetet e tjera dhe motorin në dispozicion të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, (limiti) shpenzimi do të jetë sipas normativës së konsumit për çdo automjet dhe (motorin,) km të kryera sipas fletë udhëtimeve të mbajtura, referuar distancave kilometrike ndërqytetëse, të miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Administrative, pranë institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR